



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA PUKË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr.1748/2 prot.

Pukë më, 20. 10. 2025

VENDIM

Nr. 38 , datë 17.10. 2025.

**“PËR
EMËRTIM RRUGËSH NË TERRITORIN E BASHKISË PUKË”
NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 47 DATË 17.12.2004, “PËR EMERTIMIN E
RRUGËVE, SHESHEVE DHE INSTITUCIONEVE TË BASHKISË PUKË”**

Në mbështetje të:

- Nenit 8 pika 2, neni 9 nënpika 1.7, shkronja “b”, neni 54 shkronja “ll”, nenit 55 pika 2 e 6 të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” (i ndryshuar),
- Nenit 2 pika 1(ç), neni 3, neni 5 pika 1, nenit 7, neni 25 e 26, të ligjit nr. 9270, datë 29.07.2004 “për sistemin e adresave” (i ndryshuar),
- Ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” (i ndryshuar),
- VKB-në nr.47 datë 17.12.2004 “Për emertimin e rrugëve, shesheve dhe institucioneve të bashkisë Pukë” Si dhe në relacionin e paraqitur nga administrata e Bashkisë në mbledhjen e datës 17. 10. 2025, me propozim të kryetarit të bashkisë, Këshilli i Bashkisë;

VENDOSI:

1. Të miratojë emërtimin e rrugës nga këndi i njoftimeve në qendër, deri te Xhamia e qytetit Pukë, me emrin **“Rruga e Xhamisë”**, sipas planvendosjes bashkëlidhur.
2. Të miratojë emërtimin e rrugës së lagjes Zezaj me emrin **“ Rruga Elez Hoxha”**, sipas planvendosjes bashkëlidhur.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari dhe Administrata e Bashkisë Pukë
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes, sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, (i ndryshuar).
5. Vendimi u shpall me date **20. 10.2025**

Vota te vlefshme gjithsej 11

Vota pro 11 , Vota kunder 0 , Vota abstenim 0

SEKRETARI


Hazbi Terbuni

KRYETARI

Gjon GJOKA




**Plani i vendosjes së rrugës që do emërtohet Rruga “Elez Hoxha”
Lagje Zezaj – Qyteti Pukë**



A handwritten signature in blue ink, appearing to be 'Besnik', written in a cursive style.

Plani i vendosjes së rrugës që do emërtohet “Rruga e Xhamisë”



03.11.21

H. Tërhan
L. Hyseni
Perviz Tuli



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT SHKODER



Nr. 670/1
prot.

Shkodër, më 31.10.2025

Lënda: Mbi Vendimet Nr. 37, 38, 39, datë 17.10.2025 të Këshillit Bashkiak Pukë.

KËSHILLI BASHKIAK PUKË

Prefekti i Qarkut Shkodër, në zbatim të detyrave të tij funksionale të përcaktuara në ligjin nr. 107/2016 "Për Prefektin e Qarkut" i përditësuar, të Urdhërit të Kryeministrit Nr. 21, datë 05.02.2025 "Për detyrat e administratës së Prefektit të Qarkut", të Urdhërit të MB Nr. 39, datë 20.02.2025 "Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut", si dhe aneksin I "Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut", të ligjit Nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen vendore", neni 54, shkronjat "ll", neni 55, pika 2, neni 64, shkronja "c", u njoh me Vendimet Nr. 37, 38, 39 datë 17.10.2025 të Këshillit Bashkiak Pukë "Emërtim sheshi, rruge", akte me karakter jo normativ. Këto akte nuk përfshihet në kategorinë e akteve normative për të cilat Prefekti në zbatim të nenit 8, shkronja "a" e ligjit nr.107/2016 "Për Prefektin" i ndryshuar, ka detyrim të shprehet. Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

PREFEKT

